

VENDIM
Nr.3, datë 19.1.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE,
SIPAS TË CILAVE BËHET SHITJA E ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUESIT VENDAS E
TË HUAJ**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “1”, dhe 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të procedurave, sipas të cilave bëhet shitja e energjisë elektrike të furnizuesit vendas e të huaj.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe këshilltari i Bordit të Komisionerëve të hartojnë këtë rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta